



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontrolli i përdorimit të simbolit të akreditimit

Kodi DA-PM-004

Rishikim nr 3
Dt 20.05.2019

Faqe 1 nga 3


Kontrolli i përdorimit të simbolit të akreditimit.

Zbatues: Stafi, kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e DPA

Përgjegjësi për zbatim: Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit

Kontrolloi: Menaxheri i Cilësisë
Ardita MELE

Miratoi: Drejtori i Përgjithshëm
Armond HALEBI

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrolli i përdorimit të simbolit të akreditimit	Kodi DA-PM-004
		Rishikim nr 3 Dt 20.05.2019
		Faqe 2 nga 3

Ky dokument përcakton mënyrën e kontrollit dhe verifikimit të përdorimit të simbolit dhe referencave tek akreditimi nga ana e organeve të akredituara.

2 Fusha e zbatimit

Kjo procedurë zbatohet nga stafi, kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e DPA në lidhje me përdorimin e logos së akreditimit. Gjithashtu kjo procedurë zbatohet kur OVK-të të cilat gëzojnë statusin e akreditimit dhe përdorin simbolin ose referencën tek akreditimi. Kjo procedurë zbatohet edhe për kontrollin e përdorimit të markave ILAC-MRA dhe IAF MRA si dhe referencave tek EA-MLA.

3 Përgjegjësitë

Zbatimi i kësaj procedure është përgjegjesi e stafit, kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e DPA dhe përgjegjës për kontrollin e zbatimit është Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit.

4 Referencat

Ky dokument bazohet :

- në standardin S SH ISO/IEC17011, paragrafi 4.3 “Kërkesa për organizmat e akreditimit që akreditojnë organizmat e vlerësimit të konformitetit”.
- Politiken e DA –PO-005
- Ligjin nr.116/2014
- Manualin e cilësisë DA-MC-001

5. Fjalori dhe shkurtime

Zbatohen ato terma dhe përkufizime që përdoren në dokumentat referuese të pikes 4.

6. Kontrolli dhe verifikimi i përdorimit të simbolit të akreditimit

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit verifikon përdorimin e simbolit dhe referencave të akreditimit, referencave tek EA-MLA dhe markave ILAC-MRA dhe IAF-MRA në vizitat mbikëqyrëse/rivlerësuese. Kur gjatë vizitave konstatohet përdorim i gabuar i simbolit të akreditimit, kryevlerësuesi e vendos atë moskonformitet të cilin e klasifikon mbi bazën e rëndësisë dhe kohëzgjatjes së përdorimit të gabuar. Afati dhe mënyra e trajtimit për zgjidhjen e moskonformitetit do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në procedurën DA-PT-001.

Në rastin e marrjes njoftim për përdorim të gabuar të simbolit, kryevlerësuesi përkatës organizon një vizitë shtesë për të verifikuar statusin e përdorimit të gabuar, kohëzgjatjen dhe rëndësinë. Kur gjatë vizitave konstatohet përdorim i gabuar i simbolit të akreditimit, kryevlerësuesi e vendos atë



Tel: +355 4 22 69097
+355 4 22 69325
Fax
E-Mail: info@dpa.gov.al

Kontrolli i përdorimit të simbolit të akreditimit

Kodi DA-PM-004

Rishikim nr 3
Dt 20.05.2019

Faqe 3 nga 3

moskonformitet. Afati dhe mënyra e trajtimit për zgjidhjen e moskonformitetit do të jetë i njëjtë me atë të përcaktuar në procedurën DA-PT-001.

Në rast se kryevlerësuesi konstaton që veprimet korigjuese të propozuara nga OVK janë të pamjaftueshme për zgjidhjen e moskonformitetit, DPA i rekomandon OVK marrjen e masave të tjera.

Mos zgjidhja e moskonformitetit është shkak për pezullimin e akreditimit sipas procedurës DA-PT-006. Në rast se edhe pas pezullimit OVK përdor në mënyrë të gabuar simbolin e akreditimit atëherë DPA kërkon fillimin e procedurës së tërheqjes së akreditimit.

Në rast pezullimi dhe tërheqje të akreditimit, departamenti i zhvillimit publikon statusin e OVK në ëbsitin e DPA dhe listën e OVK të akredituara.

7. HISTORIKU

Data e Ripunimit	Numri i Ripunimit	Autori	Përshkrimi i ndryshimeve të bëra
30.10.2006	0	A. Cuni	Varianti fillestar
20.02.2008	1	A.Fuga	Ndryshime në pikën 4 referencat dhe në pikën 9
22.12.2014	2	E.Fyshku	Ndryshime header dhe ne pikat 2; 4; 6.
20.05.2019	3	B.Qazimi	Ndryshime ne piken 4